REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIAMALLAKASTËR**

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËPERIUDHËN JANAR - MARS 2024**

| Nr. Ren d or | Data e kërkesë s | Objekti i kërkesës | Data e përgjigje s | Përgjigje | Mënyrae përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 01 | 12.01.2024 | Kërkesë për informacionnë lidhje me transparencën e njësive të Vetëqeverisjes vendore për shumën vjetore të shpenzuar nga bashkia për hostimin ,domainin dhe shërbimet e faqes zyrtare ëeb të Bashkisë për vitin 2023<br>A ka një program transparence dhe kur është miratuar ai.<br>Sa është nr. i kërkesave për informim që kanë ardhur elektronikisht në bashki. | 16.01.2024 | Në bazë të ligjit 119/2014 “Për te Drejtën e Informimit”,Jubëjmëme dije se: Shuma vjetore e shpenzuar nga Bashkia për vitin 2023 për hostimin domainin është 22500( lekë)<br>Bashkia ka një program të miratuar transparence. Është bërë miratimi i programit të Transparencës në vitin 2018 me vendim nr. 83 datë 10.11.2018<br>Numri i kërkesave për informim që kanë ardhur vetëm elektronikisht në adresën e koordinatorit për të Drejtën e Informimit është 9. | Përfunduar elektronikisht | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 02 | 16.01.2024 | Kërkesë për informacion në lidhje me:<br>Numrin e akteve ligjore që janë konsultuar me organizatat jofitimprurëse gjatë vitit 2023.<br>Numrin e OJF që kanë marrë pjesë në konsultime.<br>A ka koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik.<br>A ka koordinator për shoqërinë civile?<br>A ka organe këshillimore pranë që funksionojnë pranë institucionit.<br>A janë të përfshirë përfaqësues të OJF në organe këshillimore të institucionit.<br>A ka patur institucioni grupe të përbashkëta pune me pjesëmarrjen e OJF.<br>A është trajnuar stafi i institucionit mbi veprimtarinë dhe funksionimin e OJF.<br>A ofron institucioni liçenca për shërbime të caktuara që ofrohen nga OJF. | 22.01.2024 | Në bazë të ligjit 119/2014 "Për te Drejtën e Informimit",Jubëjmëme dije se: 1 akt ligjor është konsultuar me organizata jofitimprurëse(Raporti i vlerësimit të Riskut të fatkeqësive dhe kapaciteteve përballuese në Bashkinë Mallakaster.<br>Forma e konsultimit që është përdorur : Dëgjesën publike, takim fizik me qytetarët dhe grupet e interesit për raportimin e vlerësimit të riskut në bashkinë Mallakastër.<br>Në këto konsultime ka marrë pjesë IDRA dhe UTS-01 të cilët përmes takimeve të organizuara kanë dhënë ndihmesë në përgatitjen dhe përmirësimin e dokumentit të vlerësimit të riskut në nivel vendor.<br>Institucioni ka koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik.<br>Institucioni nuk ka koordinator për shoqërinë civile.<br>Nuk ka organe këshillimore që funksionojnë pranë institucionit tonë.<br>Ka patur grupe të përbashkëta pune me pjesëmarrjen e OJF.<br>Bashkia në partneritet me organizatën Help dhe Qendrën Sociale po zbatojnë projektini qëndrueshëm i shërbimeve të integruara të punësimit dhe kujdesit shoqëror në bashkinë Mallakastër .Numri i OJF pjesëmarrëse 2.<br>Nuk janë zhvilluar trajnime mbi veprimtarinë dhe funksionimin e OJF -ve.<br>Të rinj dhe gra të papunë do të përfitojnë shërbime të caktuara që ofrohen nga OJF: kurse profesionale, të cilët në fund të kurseve do të pajisen me çertifikata. | Përfunduar elektronikisht | Pa pagese |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 03 | 01.02.2024 | Kërkesë për informacion në lidhje me :<br>Programet e trajnimit për personat eprekur nga dhuna në familje.<br>Sa persona janë trajnuar deri tani ,a ka pasur probleme me dhunuesit kur janë marrë në mbrojtje personat e dhunuar.<br>Sa raste me urdhër mbrojtje janë regjistruar gjatë periudhës 2022-2024.<br>Sa raste janë regjistruar si dhunë në familjegjatë vitit 2023.<br>Sa është fondi i parashikuar në buxhet për trajtimin dhe ndihmën ndaj viktimave të hunës në familje | 08.02.2024 | Në bazë të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit",Ju bëjmë me dije se:Gjatë periudhës 2022-2024 janë trajtuar 46 raste të dhunës në familje .<br>20 raste prej tyre i përkasin vitit 2023.Gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje nuk ka patur probleme me dhunuesit. Aktualisht bashkia nuk ka programe trajtimi për personat e prekur nga dhuna.Përsa i përket fondit nuk ka një fond të parashikuar në buxhet për trajtimin dhe ndihmën e kësaj kategorie. | Përfunduar elektronikisht | Pa pagesë |
| 04 | 22.02.2024 | Kërkesë për informacion në lidhje :<br>A kanë përfituar OJF-të fonde publike nga institucioni gjatë vitit 2023.<br>Cila ka qenë forma e përfitimit të tyre .<br>Sa OJF kanë përfituar nga këto fonde publike .<br>Keni ofruar mbështetje jo-financiare për OJF gjatë vitit 2023 | 27.02.2024 | Në bazë të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit",Ju bëjmë me dije se:OJF-të nuk kanë përfituar fonde publike nga institucioni .<br>Nuk kanë aplikuar OJF për fonde publike.<br>Nuk është ofruar mbështetje jo-financiare për OJF-të | Përfunduar elektronikisht | Pa pagesë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 05 | 08.03.2024 | Kërkesë për informacion në lidhje me delegimin e kompetencave ligjore te një vartësi juaj si më poshtë | 13.03.2024 | Në bazë të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”,Ju bëjmë me dije Urdhrin administrativ Nr.01 datë 06.03.2024 për delegim kompetencash për nënshkrimin e disa akteve administrative | Përfunduar elektronikisht | Pa pagesë |